VENDIM
Nr. 211, datë 18.12.2019

MBI SHTYRJEN E PERIUDHËS TRANZITORE PËR BËRJEN EFEKTIVE TË TRANSFERIMIT TË LICENCAVE TË OPERIMIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË SHOQËRISË OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SHA (OSHEE SHA), TE SHOQËRIA OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SHA (OSSH SHA); LICENCËS SË FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE DETYRIMIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL TË FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË SHOQËRISË OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SHA (OSHEE SHA), TE SHOQËRIA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL SHA (FSHU SHA)"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germat "c", "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neni 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe nenit 15 i "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 118 prot., datë 13.12.2019, mbi shtyrjen e periudhës tranzitore deri në datën 31.12.2019, për bërjen e efektive të transferimit të licencave të operimit të sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), te shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a. (OSSH sh.a.),

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 264, datë 20.12.2018, vendosi:

1. Përcaktimin e një periudhe tranzitore prej 12 muajsh, për bërjen e efektive të transferimit të licencave të operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a), te shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a. (OSSH sh.a.); miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 216, datë 11.10.2018; licencës së furnizimit të energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të Furnizimit të Energjisë Elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a), te shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a.), miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 215, datë 11.10.2018.

2. Deri në përfundimin e periudhës tranzitore prej 12 muajsh, veprimtaritë e operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike; furnizimit të energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, do të vazhdojnë të kryhen nga OSHEE sh.a.

- Në lidhje me këtë vendimmarrje, ERE ka vijuar komunikimet me OSHEE sh.a. për të marrë informacion mbi këtë proces dhe së fundmi i është drejtuar me shkresën nr. 719 prot., datë 7.11.2019, me anë të së cilës i është kërkuar informacion mbi ecurinë e procesit të ndarjes së OSHEE sh.a.

- OSHEE sh.a. i është përgjigjur me shkresën nr. 23524/1 prot., datë 3.12.2019, protokolluar në ERE me nr.719/1, datë 6.12.2019, nëpërmjet së cilës i kërkon ERE shtyrjen e periudhës tranzitore deri në datën 31.12.2019, duke sqaruar se:

- në vijim të punës përgatitore të OSHEE sh.a. për procesin e ndarjes së shoqërisë, si dhe në kuadër të orientimeve, takimeve, diskutimeve të zhvilluara në zbatim të urdhrit nr. 341, datë 17.9.2019, "Për ngritjen e grupit të punës për ndarjen e OSHEE sh.a.", të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, është në pritje të ndryshimeve të nevojshme të akteve ligjore dhe nënligjore, në

mënyrë që të vijohet me finalizimin e procesit të ndarjes së OSHEE sh.a. dhe që operatorët e krijuar të jenë plotësisht operativë në datën 1.1.2020.

- Duke qenë se nga ana e OSHEE sh.a. dhe MIE janë marrë masat e nevojshme për lehtësimin dhe përfundimin e procesit të ndarjes efektive të OSHEE-së, përpara janarit 2020.

- Duke marrë në konsideratë që periudha tranzitore, miratuar me vendimin nr. 264, datë 20.12.2018, të Bordit të ERE-s, përfundon në datën 21.12.2019.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 164, datë 4.11.2019, është shprehur "Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a.) në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nga data 21.12.2019.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e OSHEE sh.a. për shtyrjen e periudhës tranzitore deri në datën 31.12.2019, për bërjen efektive të transferimit të licencave të operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), te shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a. (OSSH sh.a.); miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 216, datë 11.10.2018; licencës së furnizimit të energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), te shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a.), miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 215, datë 11.10.2018.

2. Deri në përfundimin e periudhës tranzitore, parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, veprimtaritë e operimit të sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike; furnizimit të energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, do të vazhdojnë të kryhen nga OSHEE sh.a.

3. Për efekt të llogaritjes së afateve të shtrirjes së fuqisë juridike të licencës së shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a.), në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, ky afat rivendoset sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij vendimi.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë OSHEE sh.a. dhe MIE për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti